

*J. G. B. Shkollari*  
*Udhëzues të Komitetit të*  
*Shqiptarëve të Bashkuarëve*  
*ditën e mërkurë të 29.01.18*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI I SHQIPËRISË

Nr. \_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/01/2018

**Lënda:** Kërkohet mocion me debat, si dhe shqyrtimi dhe miratimi në seancën plenare të Projektrezolutës "Për ndryshimin e qëndrimit të mbajtur nga Qeveria Shqiptare mbi Rezolutën "Për statusin e Jeruzalemit" të OKB të datës 21 Dhejtor 2017"

**Drejtuar:** ZOTIT GRAMOZ RUÇI  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

**Baza Ligjore:** Nenet 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit

Z. Ruçi,

Megjithë kërkesat e vazhdueshme të Komisionit Parlamentar për Punët e Jashtme, Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, vijon të mos konsultohet me pushtetin ligjvënës, mbi çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me politikën e jashtme. Në këtë frymë mungese bashkëpunimi dhe konsultimi, ishte edhe qëndrimi i mbajtur nga Qeveria Shqiptare lidhur me Deklaratën e Samitit Organizatës së Bashkëpunimit Islamik të mbledhur në Stamboll më 13 Dhjetor 2017, e cila përmban veprime të njëanshme lidhur me statusin e Jeruzalemit, sulme të padrejta e të padobishme ndaj partnerit tonë strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe përjashtimin e tyre nga procesi i paqes në Lindjen e Mesme. Gjithashtu, pa asnjë proces konsultimi dhe informimi, ishte edhe vota pro në OKB ndaj Rezolutës "Për statusin e Jeruzalemit", të miratuar më 21 Dhjetor 2017.

Në këtë drejtim, vlerësojmë se qëndrime të tilla janë të papranueshme dhe Kuvendi duhet menjëherë të distancohet dhe të kërkojë nga Qeveria, të ndër marrë hapat e nevojshme për rregullimin e kësaj situate. Ndërmarrja e veprimeve aktive në kundërshtim me qëndrimin e partnerit tonë strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk duhet të përkrahen nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, sepse kjo bie ndesh me interesin tonë kombëtar dhe interesat e qytetarëve shqiptar.

Nisur nga sa më lart, në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim këtë mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për qëndrimet e papranueshme të Qeverisë Shqiptare mbi këtë çështje, sipas tekstit bashkëlidhur kësaj kërkesë për zhvillimin e mocionit. Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Shqipërisë të ProjektRezolutës "Për ndryshimin e qëndrimit të mbajtur nga Qeveria Shqiptare mbi Rezolutën "Për statusin e Jeruzalemit" të OKB të datës 21 Dhejtor 2017"

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

Tota Shk	Edmond Spata	Edmond Spata	Petar Vasil
Aldo Bume	Bume	Edmond Spata	Kleja Gasha
EDI PALOKA			Edmond Spata
Edmond Chankresti			Panpani Sp.
Wasej Wase			Leffer Koka
Vluta Dushy			
Aora Malaj			
Ilvis Brollin			
Aene			
Esuir			



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI I SHQIPËRISË**

**PROJEKT**

**REZOLUTË**  
Nr. \_\_\_\_\_/2018

**PËR NDRYSHIMIN E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA QEVERIA  
SHQIPTARE MBI REZOLUTËN “PËR STATUSIN E JERUZALEMIT” TË  
OKB TË DATËS 21 DHEJTOR 2017**

Në mbështetje të neneve 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI I SHQIPËRISË:**

Duke synuar ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Lindjen e Mesme dhe në Botë;

Duke qenë të vetëdijshëm për rolin e pazëvendësueshëm që Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) luajnë e do të luajnë për tejkalimin e konflikteve, bashkëzistencën dhe vendosjen e demokracisë në atë Rajon;

Duke pasur një besim të pa tundur se pozicionimi amerikan është në mbrojtje të vlerave, lirisë dhe parimeve universale;

Duke konsideruar ShBA si partneri kryesor gjeo-strategjik të vendit tonë, Kosovës së lirë, shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi e kudo ku janë;

Duke provuar konkretisht këtë rol të padiskutueshëm amerikan si faktori kryesor i arritjeve madhore jo vetem për kombit tonë, por edhe për të gjithë Rajonin tonë;

Duke shprehur miqësinë ndaj Shtetit të Izraelit, një vend mik dhe demokratik në Lindjen e Mesme;

Duke shprehur miqësinë ndaj popullit palestinez e duke përkrahur të

drejtën e tij për të patur një shtet të qendrueshëm përmes negociatave e marreveshjes;

Duke mbështetur pa rezerva procesin e paqes përmes negociatave mes Izraelit dhe Autoritetit Palestinez, bazuar në vizionin e dy shteteve fqinjë e në paqe me njeri-tjetri e me vendet e rajonit;

Duke apeluar OKB, ShBA , BE dhe të gjithë aktorët ndërkombëtarë që të angazhohen në procesin e paqes në menyrë aktive e konstruktive në Lindjen e Mesme;

Duke konstatuar se disa komunikata e rezoluta të miratuara në Dhjetor 2017 për këtë çështje janë të njëanshme, jokonstruktive, me gjuhë të papërshatshme dhe nuk i shërbejnë procesit të paqes e gjetjes së një marrveshjeje mes palëve;

Duke qenë të shqetësuar nga miratimi nga ana e Qeverisë shqiptare i Komunikatës Finale dhe Deklaratës së Samitit të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, të mbledhur në Stamboll më 13 Dhjetor 2017, e cila përmban veprime të njëanshme lidhur me statusin e Jeruzalemit, sulme të padrejta e të padobishme ndaj ShBA, si dhe përjashtimin e tyre nga procesi i paqes në Lindjen e Mesme;

Duke qenë të shqetësuar nga vota pro e Qeverisë shqiptare për Rezolutën "Për statusin e Jeruzalemit", të miratuar më 21 Dhjetor 2017 në Asamblenë e Përgjithshme të OKB, përmbajtja e së cilës nuk ndihmon në procesin e paqes dhe i kundërvihet qëndrimit të një vendi sovran, ShBA-ve, që kanë rol thelbësor për zgjidhjen e problemeve aty;

Duke gjykuar se miratimi nga ana jonë e këtyre Rezolutave, që godasin vendimin e ShBA, është edhe një akt flagrant në kundërshtim me interesat tona kombëtare;

Duke shprehur keqardhje që këto veprime të Qeverisë u bënë pa informuar Kuvendin e pa u konsultuar me Komisionin e Punëve të Jashtme, si dhe duke përjashtuar Presidentin e Republikës nga procesi konsultativ-vendimmarrës;

## **KUVENDI I SHQIPËRISË:**

I kërkon menjëherë Qeverisë:

1. Të distancohet zyrtarisht e publikisht nga Komunikatat Finale e Deklarata e Samitit të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, më 13 Dhjetor 2017.
2. Të rishikojë votën për rezolutën "Për statusin e Jeruzalemit" të datës 21 Dhjetor 2017, të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, e në përputhje me rregullat e OKB të deklarojë një qendrim jo miratues ndaj kësaj Rezolute.
3. Të informojë brenda një muaji Kuvendin lidhur me përmbushjen e detyrave si më lart.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUCI**